



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 20.9.2018

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8318, DATË 1.4.1998, “PËR DHËNIEN ME QIRA TË TOKËS BUJQËSORE E PYJORE, TË LIVADHEVE DHE KULLOTAVE QË JANË PASURI SHTETËRORE”, TË NDRYSHUAR””

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e komisionit përgjegjës, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8318, datë 1.4.1998, “Për dhënie me qira të tokës bujqësore e pyjore, të livadheve dhe kullotave që janë pasuri shtetërore”, të ndryshuar””, në mbledhjen e datës 20 shtator 2018.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Projektligji parashikon përcaktimin e kushteve të ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale, si dhe objekteve në funksion të agroturizmit në tokat bujqësore që janë pasuri shtetërore, me destinacion dhënie me qira të tyre, me qëllim rritjen e investimeve dhe të efektivitetit të përdorimit të tyre.

Duke qenë se gjatë procesit të qiradhënies, ndërtimi i objekteve për realizimin e të gjithë ciklit (prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin) e produkteve bujqësore e blegtorale, nuk është i përcaktuar në dispozitat e ligjit në fuqi, është parë e nevojshme të ndërhyhet në ligjin ekzistues duke bërë të mundur realizimin e ndërtimeve përkatëse dhe kushtet specifike të nevojshme, të cilat rregullojnë edhe marrëdhëniet e qiradhënësit me qiramarrësin.

Konkretisht projektligji parashikon:

- Dispozita shtesë për lejimin e ndërtimit të objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore e blegtorale apo objekte në funksion të agroturizmit, për të cilat kërkohet leje ndërtimi, si dhe ndryshimin e kategorisë së resursit nga “tokë bujqësore” në tokë “truell”. Këto ndërtime do të bëhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit dhe dokumentet përkatëse (planin e përgjithshëm vendor të bashkisë) në territorin e së cilës gjendet toka, objekt i qiradhënies.
- Për objektet e ndërtuara sipas këtij projektligji, nuk lejohet në asnjë rast që të ndryshohet destinacioni i funksionit të tyre, pasi ato realizohen në shërbim të qëllimit të qiramarrjes.
- Pas ndërprerjes apo përfundimit të afatit të qiradhënies, objekti ndërtimor kalon në pronësi të qiradhënësit, pa shpërblim;

- Kur mbi sipërfaqen e tokës, objekt i qiradhënies, parashikohet kryerja e një investimi për interes publik, atëherë kompensimi i qiramarrësit, për shpenzimet e kryera, bëhet nga enti përgjegjës për zhvillimin e projektit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për shpronësimet për interes publik. Ndërkohë, shfuqizohet dispozita ku parashikohet detyrimi që ka qiradhënësi për të kompensuar qiramarrësin për shpenzimet e kryera, në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit Civil dhe të tipit të investimit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk morën pjesë në mbledhje.

Andrea MARTO

Relator

Eduard SHALSI

Kryetar